



## MESHA E DHURATAVE TE PARASHENJTËRUARA

*Mesha Hyjnore e të Parashenjtëruarave, e cila bëhet shenjtërimin e besimtarëve, kryhet në çdo të mërkurë e të premte të Kreshmëve të Mëdha që janë ditë pësimi të Krishtit. Gjithashtu kryhet të enjten e Javës së 5-të të kreshmëve për arsye të Kanunit të madh, të Hënën e Madhe, të Martën e Madhe, dhe të Mërkurën e Madhe si edhe në të kremtet e gjetjes së parë e të dytë të kokës së Pararendësit të Nderuar (24 shkurt), të 40 Dëshmorëve të shenjtë (9 mars) edhe në çdo të kremte lokale kur ato bien ditë e hënë, të martën, të mërkurën, të enjten ose të premtën e Kreshmëve të Mëdha. Përkundrazi, ditën e së kremtes së Ungjillëzimit, në çfaredo ditë që ajo të bjerë, kryhet Mesha hyjnore e shën Joan Gojartit.*

*Mesha hyjnore e të Parashenjtëruarave kryhet gjithnjë pas Orëve në shërbesën e Mbrëmjes për arsye të agjërimit gjatë gjithë ditës. Dhe zakonisht kryhet vetëm nga një prift pa dhiak, me përjashtim të të kremteve dhe të Javës së Madhe që kanë Ungjill.*

*Ata që marrin pjesë në Meshë, në kohën kur lexohet Ora e Nëntë, si marrin «qero», hyjnë në Hierore dhe vishen me veshje të zeza pa kryq dhe epigonat. Prifti bekon në formë kryqi dhe puth çdo veshje pa thënë uratat përkatëse, po vetëm: «Le t'i lutemi Zotit». Po kështu vepron edhe dhiaku. Në qoftë se merr pjesë kryepriifti (episkopi ose kryepiskopi), ai qëndron në parafron, pa mandian, duke mbajtur vetë mbikalimafin dhe engolpin dhe në dorë patericën. Mund të bëhet edhe Meshë Arkieratike, të cilën e kryen episkopi ose kryepiskopi pa mitrën dhe omoforin e madh. Në rast nevojë mund të bëhet edhe hirotonisje dhiakoni pas Hyrjes së Madhe. Si nëndhiak ai hirothetiset pas përlëshimit të tipikave dhe para shërbesës së Mbrëmjes prej kryepriiftit, i cili mban Epitrahilin dhe Omoforin e vogël. Rregullin për pjesëmarrjen e kryepriiftit në Meshën e të Parashenjtëruarave shikoje më gjerë e gjatë në fund të Meshës.*

## MESHA HYJNORE E DHURATAVE TË PARASHENJTËRUARA

*Në kohën kur lexohet Ora IX ose Ora VI, del prifti para Derës së Bukur dhe si falet tri herë, thotë:*

O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiromë.

*Pastaj, puth me shpresëtari ikonat e shenjta të Krishtit e të Hyjlindëses dhe si kërkon ndjesë nga ana e psaltëve dhe e popullit, hyn në Hierore pa thënë gjë, falet para Tryezës së Shenjtë dhe vishet me veshjen e zakonshme.*

*Pas uratës: «Perëndia na përdëlleftë ...» si edhe pas thënies: «Shenjt Perëndi», tri herë e të tjera të Orës IX, prifti brenda në Hierore thotë këtë uratë:*

O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti me të njejtën qenie, mbretëria e pandarë, shkaku i të gjithë të mirave, pranomë me mirësi tani dhe mua mëkatarin: forcomë, urtësoma zemrën dhe pastromë nga çdo ndyrësi; ndriçoma mendjen që të lavdëroj, të himnoj e të them gjithnjë: Një është Shenjt, një është Zot, Iisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

*Pastaj hapet Dera e Bukur dhe prifti bën përlëshimin e vogël të Shërbesës së Mëngjesit, duke e mbyllur me «Uratat e Etërve tanë...» dhe fillon Shërbesën e Mbrëmjes bashkë me Meshën Hyjnore të Dhuratave të Parashenjtëruara.*

\*

*Prifti dhe dhiaku qëndrojnë përpara Tryezës së Shenjtë, bëjnë tri metanira e thonë:*

O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiromë.

*Dhe prifti puth Ungjillin e shenjtë, ndërsa dhiaku, si puth Tryezën e Shenjtë dhe dorën e djathë të priftit, del nga Hierorja, qëndron te vendi i zakonshëm dhe si falet tri herë, thotë me zë të lartë:*

**Dhiaku:** Beko, o Zot.

*Prifti ngre Ungjillin dhe duke bërë me të shenjën e Kryqit mbi Andiminsin thotë:*

**Prifti:** E Bekuar është mbretëria e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Dhe mbyllet pjesa e poshtme e Derës së Bukur.*

*Dhiaku hyn në Hierore duke thënë me vete psalmin 103.*

### **Lexuesi**

**(Anagnosti):** Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Perëndisë, Mbretit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Krishtit, Perëndisë Mbretit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë vetë Krishtit Perëndisë dhe Mbretit tonë.

### *Psalmi 103*

Beko Zotin, o shpirti im.

O Zot Perëndia im, fort u madhështove; je veshur me lavdi e me madhështi.

Ti që hedh përmbi vete dritën posi rrobë; Ti që shtrin qiellin posi kurtinë.

Ti që mbështet mbi ujërat ndërtesat e tua të larta,

Ti që përdor retë për ngjitjen tënde, që ecën mbi fletët e erërave.

Ti që bën erërat lajmëtarë të tu dhe flakët e zjarrit shërbyes të tu.

Ti që vendos dheun mbi themelet e tij të sigurta që të mos tundet në jetë të jetëve.

E mbështolle atë me avushë, si me rrobe; ujërat qëndrojnë mbi malet.

Prej qortimit tënd ikin; prej zërit të bubullimës sate tërhiqen të trembura.

Ngrihen malet, shtrihen fushat, në vendin që u caktove.

U vure kufi ujërave që nuk do ta kapërcejnë, as do të kthehen për të mbuluar dhe.

Ti që dërgon burime ndër përrrenjtë, përmes maleve kalojnë ujëra. Pinë ujë gjithë egërsirat e fushës; gomarët e egër presin që të shuajnë etjen e tyre.

Pranë atyre rrijnë shpendët e qiellit, përmes degëve dëgjohet zëri i tyre. Ti ujit malet prej vendeve të tua të larta; nga fruti i pemëve të tua nginjet dheu.

Ti që bën të mbijë bar për kafshët dhe barishte për shërbim të njeriut, që të nxjerrë ushqimin nga toka: verën që gëzon zemrën e njeriut, vajin që i ndriçon faqen dhe bukën që forcon zemrën e njeriut. Nginjen drutë e fushës, dëllinjat e Libanit që mbolle.

Atje ngrejnë zogjtë çerdhe, banesa e shtërgut qëndron më lart se ato. Malet e lartë janë për drerët, shpellat janë strehë për lepurat. Bëre hënën për motet, dielli njeh të perënduarit e tij.

Përhap errësirën dhe bëhet natë, gjatë së cilës bredhin tërë egërsirat e pyllit.

Luanët ulërijnë për të gjuajtur dhe për të kërkuar nga Perëndia ushqimin e tyre.

Lind dielli, mblidhen dhe bien e flenë nëpër strofkat e tyre.

Del njeriu në punën dhe në mundimin e tij gjer në mbrëmje.

Se madhështore janë veprat e tua, o Zot, të gjitha i ke bërë me urtësi; dheu është plot me krijesat e tua.

Ja deti i madh e i gjërë, atje janë shtërpinj të panumërt, qenie të gjalla, të vogla e të mëdha.

Atje kalojnë lundra; atje është dragoi që krijove për të luajtur në të. Të gjitha presin prej teje që t'u japësh ushqimin në kohë; atë që u jep e mbledhin.

Me të hapur Ti dorën të gjitha mbushen me të mira, me të kthyer Ti fytyrën në anën tjetër, ato tronditen.

Kur Ti u merr frymën, ato vdesin dhe rikthehen në baltën e tyre. Kur dërgon frymën tënde, ndërtohen dhe përtërit faqen e dheut.

Lavdia qoftë e Zotit për jetë.

Zoti ngazëllohet për veprat e tij.

Kur shtie sytë mbi dheun, e bën që të dridhet; kur prek malet nxjerrin tym.

Do t'i këndoj Zotit sa të rroj, do t'i psal Perëndisë tim sa të jem gjallë. Shprehjet e mia qofshin të ëmbëla për të dhe unë do të ngazëllohem më Zotin.

U shofshin mëkatarët dhe të paligjtë prej dheut, në mënyrë që të mos jenë më,

Beko Zotin, o shpirti im.

Dielli njeh të perënduarit e tij.

Ti përhap errësirë dhe bëhet natë.

Sa madhështore janë veprat e tua, o Zot, të gjitha i ke bërë me urtësi.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Alilua, Alilua, Alilua, lavdi me Ty, o Perëndi *(tre herë)*, o Zot, shpresa jonë, lavdi me Ty.

*Në kohën që lexohet ky psalm, prifti qëndron pa kalimaf para Tryezës së Shenjtë dhe lexon me zë të ulët uratat 5, 6 e 7 të Liknikut, sepse uratat 1, 2, 3 dhe 4 së bashku me thirrjet lavdëruese do të lexohen gjatë Andifonëve.*

*Pasi mbarohet psalmi 103, dhiaku del nga dera e veriut, qëndron përpara Derës së Bukur dhe thotë paqësoret. Në mungesë të dhiakut i thotë prifti përpara Tryezës së shenjtë.*

**Dhiaku:** Me paqe le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Për paqem që lartazi, dhe për shpëtimin e shpirttrave tanë, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Për paqen e tërë botës, qëndrimin e mirë të Kishave të shenjta të Perëndisë, dhe për bashkimin e të gjithëve, le t'i lutemi Zotit.

- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për këtë shtëpi të shenjtë dhe për ata që hyjnë brenda në të me besë, shpresëtari dhe frikë Perëndie, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për Kryepiskopin (*ose episkopin*) tonë (*aksh*), të nderuarën presviteri dhe dhiakonatën më Krishtin, për tërë klerin dhe popullin, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për Republikën e Shqipërisë, qeverinë, ushtrinë, dhe gjithë popullin, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për këtë qytet (*ose manastir të shenjtë*), çdo qytet dhe vend dhe për ata që banojnë ndër to me besë, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për erëra të mira, begati të pemëve të dheut, dhe për kohë me paqe, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për ata që lundrojnë, që udhëtojnë, për të sëmurët, vuajtësit, robërit dhe për shpëtimin e tyre, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë Shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njerit-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

*Ndërkaq prifti, duke u përkulur, lexon me zë të ulët uratën e Andifonit të parë.*

**Prifti:** *(pa zë)* O Zot i dhembshur dhe perdëllyes, zemërgjërë dhe i shumëmëshirshëm, dëgjo faljen tonë, dhe veri re zërit të lutjes sonë; Bëna shenjë për të mirë, prina në rrugën tënde që të ecim në të vërtetën tënde; ngazëllo zemrat tona që t'i kemi frikë që të emrit tënd të shenjtë; se Ti je i madh dhe bën vepra të çuditshme; Ti je Perëndia i vetëm, dhe ndër perënditë s'ka tjetër të ngjashëm me ty, o Zot; i fortë në meshirë dhe i mirë në fuqi, për të ndihmuar dhe ngushëlluar dhe shpëtuar gjithë ata që shpresojnë me emrin tënd të shenjtë.

*(me zë të lartë)* Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Lexuesi**

**(Anagnosti):** Amin.

*Dhe lexon Kathismen XVIII në tre qëndrime (ndërpresje).*

### *Psalmi 119*

Në kohë hidhërimesh i thirra Zotit dhe më dëgjoji.

O Zot, shpëto shpirtin tim prej buzësh të padrejta dhe prej gjuhe dredhake.

Ç'mund të të japë dhe të të shtojë gjuha dredhake?

Shigjeta të të fortit të mprehura bashkë me thëngjij prej drurësh të shkretëtirës.

Mjerë unë që rri në Mesek dhe banoj në tendat e Kedarit.  
Për një kohë të gjatë ndenji shpirti im me ata që urrejnë paqen.  
Unë isha për paqem dhe kur u flisja, ata më luftonin më kot.

### *Psalmi 120*

Ngrita sytë e mi ndër malet, prej nga do të vijë ndihma ime.  
Ndhma ime është prej Zotit, që krijoi qiellin edhe dheun.  
Ai mos lejofhtë që të lëkundet këmba jote, as që ta zerë gjumi atë që të ruan.  
Ja, nuk do të dremit, as nuk do ta zerë gjumi atë që ruan Israelin.  
Zoti të ruajtë, Zoti qoftë mburoja e së djathtës sate.  
Ditën dielli nuk do të të djegë, as hëna natën.  
Zoti të ruajtë nga çdo e keqe, Zoti të ruajtë shpirtin,  
Zoti ruajtë hyrjen tënde dhe daljen tënde që tani e gjer në jetët.

### *Psalmi 121*

U ngazëllova kur më thanë: do të vemi në shtëpinë e Zotit.  
Dhe ja, këmbët tona tek shkelin pragjet e tua, o Jerusalem.  
Jerusalemi ngrihet si një kështjellë dhe është i bashkuar ngushtë.  
Atje ngjiten fiset, fiset e Zotit, për të lavdëruar emrin e Zotit sipas ligjit të Izraelit.  
Se atje u vendosën frone për gjykim, fronet e shtëpisë së Davidit.  
I uroni paqe Jerusalemit dhe i thoni: ata që të duan le të gëzojnë qetësi.  
Le të vijë paqja me fuqinë tënde dhe bollëku në kullat e tua.  
Për hir të vllëzërve të mi dhe të afërmve të mi kërkoj paqe për ty.  
Për hir të shtëpisë së Zotit Perëndisë sonë, lyp çdo të mirë për ty.

### *Psalmi 122*

I ngrita syt e mi tek ti që banon që qiell.  
Ja, sikurse sytë e shërbëtorëve vështrojnë duart e zotërinjve, sikurse sytë e shërbëtores shikojnë duart e zonjës së saj, ashtu edhe sytë tanë vështrojnë Zotin Perëndinë tonë, gjersa t'i vijë keq për ne.  
Mëshirona, o Zot, mëshirona, se u përbuzëm për së tepërmi.  
Për së tepërmi u mbush shpirti ynë me sharjet nga të pasurit dhe me urrejtjet nga kryelartët.

## Psalmi 123

Po të mos ishte Zoti me ne, le të thotë pra Izraeli, po të mos ishte Zoti me ne, kur ngriheshin njerëzit kundër nesh, atëherë do të na përpinin të gjallë.

Kur ndizej zemërimi i tyre kundër nesh; me siguri uji do të na përmbyste. Shpirti ynë ka kaluar përmes përroi të rrëmbyeshëm; shpirti ynë ka kaluar përmes uji të tmerrshëm.

I bekuar qoftë Zoti që nuk na dorëzoi si gjah në dhëmbët e atyre. Shpirti ynë shpëtoi porsì zog prej lakut të gjuetarëve, Laku u dërrmua dhe ne shpëtuam.

Ndihma jonë është me emrin e Zotit që bëri qiellin edhe dheun.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani e përherë e ne jetë të jetëve. Amin.

Alilua, Alilua, Alilua. Lavdi më Ty, o Perëndi. Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

*Ndërkaq dhiaku, si bën përkuljen e zakonshme, hyn në Hierore, lan duart dhe rregullon Proskomidhinë. Pastaj vjen prifti edhe lan edhe ai duart.*

*Dhiaku merr temjanicën të ndezur dhe me zë të ulët i thotë priftit:*

Beko, o Zot, temjamin.

*Prifti e bekon duke thënë me zë të ulët uratën e temjamt:*

I bekuar është Perëndia ynë gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin. Temjam po të sjellim, o Krisht Perëndia ynë, si erë kundërmimi shpirtëror, të cilin, pasi ta pranosh në altarin tënd përmbiqiellor, të na dërgosh si shpërblim hirin e Shpirtit tënd të tërëshenjtë.

*Kur fillon leximi i Psaltirit mbyllet plotësisht Dera e Bukur dhe prift pa kalimaf shpalos Andiminsin mbi Tryezën e Shenjtë, vjen në Proskomidhi, merr Dhiskun, Yllin dhe Mbulesën edhe i sjell në Tryezën e Shenjtë. Dhe, si merr nga Artofori Bukën e Shenjtë të parashenjtëruar, e vendos atë në Dhisk me shpresë-tari të madhe; pastaj vendos Yllin mbi to, duke thënë:*

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Iisu Krisht, Perëndia ynë, mëshirona dhe shpëtona.

*Dhe e mbulon atë me Mbulesën duke thënë po: «Me uratat...». Pastaj merr temjanicën, i temjanis tri herë dhe si bën tri metanira të mëdha, i ngre të Shenjtat mbi kryet e tij dhe vjen në Proskomidhi, duke patur përpara dhiakun (ose shërbyesin) me llambadhë dhe temjanicë, dhe i vendos atjë.*

*Pastaj hedh në Potirin e Shenjtë verë edhe ujë bashkë, duke thënë po:*

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, ...

*Dhe e mbulon atë me Mbulesën e vet dhe të dyja pastaj (Dhiskun dhe Potirin) i mbulon me Ajrin, duke i temjanisur tri herë e duke thënë po: «Me uratat...». Shkon pastaj në Tryezën e Shenjtë dhe e temjanis tri herë atë dhe gjithë priftërinjtë. Urata e Proskomidhisë nuk thuhet, sepse është theore e parashenjtëruar, e parakryer dhe e parapranuar.*

**Dhiaku:** *(me zë të lartë)* Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Përendisë, le t'ia parashetrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

*Në kohën që dhiaku thotë sa më sipër, prifti, duke u përkulur, lexon pa zë uratën e Andifonit të dytë:*

**Prifti:** (pa zë) O Zot, mos na qorto me zemërimin tënd, as mos na dëno me mërine tënde, po tregohu ndaj nesh sipas butësisë sate, o mjek dhe shërues i shpirtrave tanë. Prina në liman të dëshirës sate. Ndriço sytë e zemrave tona, për njohjen e së vërtetës sate; dhe dhurona pjesën e ditës që mbetet edhe tërë kohën e jetës sonë me paqe dhe të pamëkatshme me ndërmjetimet e Hyjlindëses së shenjtë dhe të gjithë shernjtorëve.

(me zë të lartë) Se yti është pushteti dhe jotja është mbretëria, dhe fuqia, dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

### Lexuesi

(Anagnosti): Amin.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Dhe vazhdon duke lexuar:*

### Qëndrimi i dytë:

#### *Psalmi 124*

Ata që kanë besim te Zoti janë si mali i Sionit; nuk do të lëkundet në jetë ai që banon në Jerusalem.

Sikurse malet qëndrojnë rreth Jerusalemit, kështu edhe Zoti qëndron rreth popullit të tij, që tani e gjer në jetët.

Se Zoti nuk do të lerë shkopin e mëkatarëve mbi fatin e të drejtëve, që të mos i zgjatin të drejtët duart e tyre në padrejtësi.

Bëju mirë, o Zot, të mirëve dhe atyreve që janë me zemër të drejtë. Por ata që rrëshqasin në rrugë të shtrembëra, do t'i shpjerë Zoti bashkë me ata që bëjnë paudhësi; paqe mbi Izraelin.

#### *Psalmi 125*

Kur e ktheu Zoti Sionin nga robëria, gjetëm ngushëllim.

Atëherë u mbush me gëzim goja jonë dhe gjuha jonë me ngazëllim.

Atëherë do të thonë kombet: Zoti bëri çudira për ata.

Çudira të mëdha bëri Zoti për ne, prandaj u ngazëlluam.  
Kthe o Zot, gjithë robërit tanë porsi lumenjtë nga jugu.  
Ata që mbjellin me lot, do të korrin me ngazëllim.  
Duke shkuar, ecnin duke mbjellë farët e tyre me lot.  
Duke ardhur do të vinë me ngazëllim, duke mbajtur duajt e tyre.

### *Psalmi 126*

Në mos ndërtoftë Zoti shtëpinë, më kot mundohen ata që ndërtojnë.  
Në mos ruajtë Zoti qytetin, më kot rri zgjuar rojtari.  
Më kot është të ngriheni që me natë, dhe pasi të keni ndenjur, më kot ngriheni ju që hani bukën e mundimit.  
Vetëm atëherë kur t'u japë gjumë të dashurve të tij, ja trashëgim i Zotit, fëmijët që janë shpërblim i pemës së barkut.  
Sikurse janë shigjetat në duart e të fortit, kështu janë dhe bijtë e të munduarve.  
Lum ata që do të plotësojnë dëshirën me anën e tyre; nuk do të turpërohen kur t'u flasin armiqve përpara portave.

### *Psalmi 127*

Lum gjithë ata që ia kanë frikën Zotit, ata që ndjekin rrugët e tij.  
Ha pemët e mundimeve të tua, do të jesh i lumtur dhe do të të shkojë mbarë.  
Gruaja jote porsi një hardhi pjellore rreth shtëpisë sate.  
Bijtë e tu si filiza ullinjsh rreth tryezës sate.  
Ja kështu do të bekohet njeriu që ia ka frikën Zotit.  
Të bekoftë Zoti prej Sionit dhe pafsh të mirat e Jerusalemit tërë jetën tënde.  
Dhe pafsh bij të bijve të tu. Paqe mbi Izraelin.

### *Psalmi 128*

Le të thotë pra Izraeli: shpesh herë më kanë luftuar që prej rinisë sime.  
Shpesh herë më kanë luftuar që prej rinisë sime, po nuk më mundën.  
Mëkatarët bënë plane mbi kurrizin tim; e zgjatën paudhësinë e tyre.  
Zoti i drejtë këputi qafat e mëkatarëve.  
U turpërofshin dhe u kthefshin prapa gjithë ata që urrejnë Sionin.

U bëfshin si bar pullazesh, i cili para se të rritet thahet.  
Me këtë nuk mbushi dorën e tij korrësi, as krahët e tij ai që lidh duajt.  
Dhe udhëtarët nuk thanë: Bekimi i Zotit qoftë mbi ju, ju keni bekuar  
në emrin e Zotit.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.  
Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.  
Aliluia, Aliluia, Aliluia. Lavdi më Ty, o Perëndi. Mëshiro,  
o Zot (*tri herë*).  
Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi,  
me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të  
lavdëruarën Zonjën tonë Hyjllindësen dhe gjithmonë Vir-  
gjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar,  
veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit  
Përëndisë, le t'ia parashetrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

*Në kohën që dhiaku thotë Lutjen e vogël, prifti, duke u  
përkulur, lexon uratën e Andifonit të tretë.*

**Prifti:** (*pa zë*) O Zot Perëndia ynë, kujtona ne shërbëtorët e  
tu mëkatarë dhe të pavleshëm kur thërresim emrin tënd  
tëshenjtë dhe mos na turpëro në pritjen e mëshirës sate;  
po falna, o Zot, gjithë ato që lypim për shpëtim, dhe  
bëna të denjë që të të duam dhe të të kemi frikë me  
gjithëzembrën tonë dhe të bëjmë në çdo gjë të shirën tënde.

(*me zë të lartë*) Se Ti je Perëndi i mirë dhe njeridashës  
dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit  
të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

## Lexuesi

(Anagnosti): Amin.

Tani e përherë, e në jetë të jetëve. Amin.

*Dhe lexon:*

### Qëndrimi i tretë:

#### *Psalmi 129*

Nga thellësitë e shpirtit thirra më ty, o Zot, o Zot, dëgjo zërin tim. Veshët e tu le t'i venë re zërit të lutjes sime.

Po të vesh re paudhësitë, o Zot, o Zot, kush ka për të mbetur? po pranë teje është ndjesa.

Për emrin tënd të prita, o Zot, shpirti im priti fjalën tënde; shpirti im shpresoi më Zotin.

Nga roja e mëngjesit gjer natën, nga roja e mëngjesit le të shpresojë Izraeli më Zotin.

Se pranë Zotit është përdëllimi dhe pranë Tij shpërblimi i shumtë dhe ai do ta çlirojë Izraelin nga të gjithë paudhësitë e tij.

#### *Psalmi 130*

O Zot, zemra ime nuk u mbajt më të madh, as sytë e mi s'u ngritën lart me mburrje.

Nuk kam shkuar pas gjërave të mëdha, as pas atyre që janë mbi fuqitë e mia.

Isha i përlulur dhe e mburra shpirtin tim, si një foshnjë e porsazvjedhur prej së ëmës, prandaj shpirti im do të shpërblehet prej teje.

Le të shpresojë Izraeli më Zotin që tani e gjer më jetët.

#### *Psalmi 131*

Kujto, o Zot, Davidin dhe tërë butësitë e tij.

Sikurse iu betua Zotit, iu fal Perëndisë së Jakovit.

A do të hyj në shtëpinë time, a do të ngjitem në shtratin tim?

A do të le që syt e mi t'i zerë gjumi dhe qepallat të dremitin dhe tamthat të qetësohen, gjersa të gjej vend për Zotin, tendë për Perëndinë e Jakovit?

Ja ku dëgjuam për atë në Efratha, e gjetëm atë në fushat e pyllit.  
Do të hyjmë në tendat e tij, do të falemi në vendin ku qëndruan  
këmbët e atij.

Ngrihu, o Zot, në vendin e prehjes sate, ti dhe arka e shenjtërimit tënd.  
Priftërinjtë e tu do të veshin drejtësi, dhe oshënarët e tu do të nga-  
zëllohen.

Për shkak të Davidit, shërbëtorit tënd, mos e kthe fytyrën nga i lyeri yt.  
Zoti i dha Davidit premtim të sinqertë dhe s'ka për ta shkelur atë.  
Do të ve pemë prej barkut tënd mbi fronin tënd.

Në ruajtshin bijtë e tu dhiatën time dhe këto fjalët e mia që do t'u  
mësoj atyre, atëherë edhe bijtë e atyre do të rrinë në fronin tënd për jetë.  
Se Zoti zgjodhi Sionin; e deshi atë për banesë të tij.

Kjo do të jetë prehja ime në jetë të jetës, këtu do të banoj se e desha.  
Duke bekuar do ta bekoj derën e saj dhe të varfërit e saj do t'i nginj  
me bukë

Priftërinjtë e saj do t'i vesh me shpëtim dhe oshënarët e saj me ngazëllim  
do të ngazëllohen.

Atje do të ngre fuqinë e Davidit, bëra gati dritë për të lyerin tim.  
Armiqtë e tij do t'i vesh me turp, po mbi atë do të lulëzojë shenjtërimi  
im.

### *Psalmi 132*

A ka gjë më të bukur e më të këndshme se sa të banojnë vëllezërit  
bashkë?

Është si miroja mbi kryet, që zbret mbi mjekërr, mjekërrën e Aaronit,  
që zbret në anën e rrobes së tij.

Është si vesa e Hermonit që zbret mbi malet e Sionit, se atje dërgoi  
Zoti bekimin, jetë të amëshuar.

### *Psalmi 133*

Ja tani bekoni Zotin gjithë ju shërbëtorët e Zotit, që qëndroni në  
shtëpinë e Zotit, në oborret e shtëpisë së Perëndisë sonë.

Ngrini edhe natën duart tuaja te vendi i shenjtë dhe bekoni Zotin.  
Të bekoftë Zoti prej Sionit, ai që bëri qiellin edhe dhenë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.  
Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.  
Aliluia, Aliluia, Aliluia. Lavdi më Ty, o Përendi (*tri herë*).  
O Zot, shpresa jonë, lavdi më Ty.

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi,  
me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të  
lavdëruarën Zonjën tonë Hyjllindësen dhe gjithmonë Vir-  
gjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar,  
veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit  
Përendisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

*Në kohën që dhiaku thotë Lutjen e vogël, prifti, duke u përku-  
lur, lexon uratën e Andifonit të katërt.*

**Prifti:** (*pa zë*) Ti që me hymne të parreshtura e me dhoksologji  
të vazhdueshme himnohesh prej fuqive të shenjta, mbush-  
na gojën me lavdërimin tënd për të madhëruar emrin tënd  
të shenjtë; dhe jepna që të bëjmë pjesë e vend bashkë  
me të gjithë ata që të kanë frikë me të vërtetë e ruajnë  
porositë e tua; me ndërmjetimet e Hyjllindëses së tërëshenj-  
të dhe të gjithë shenjtorëve të tu.

(*me zë të lartë*) Se Ti je Perëndia ynë, Perëndi që mëshiron  
dhe shpëton dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit  
edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Në këtë kohë hapet vetëm perdja e Derës së Bukur, ndërsa  
psaltët psalin «O Zot, thirra...» me stihiratë sipas rregullave  
të tipikojt (tropari i ditës me melodi të veçantë (idhiomellon)  
dy herë, tropari për martirë (martirikon), tre troparet e triodhit  
me melodi të njëjtë (prosomia) dhe katër të tjerat të mineos.*

*Kur këndohet, «o Zot thirra», dhiaku del me temjanicë dhe temjanis sipas rregullit.*

*Kur psalet Lavdia, hapet Dera e Bukur; prifti së bashku me dhiakun bëjnë hyrjen e vogël nga Dera e veriut me temjanicë ose kur është e kreme e ndonjë shenjtë, si dhe Javën e Shenjtë e të Madhe, me Ungjill.*

*Kur vijnë e qëndrojnë në vendin e zakonshëm, dhiaku thotë:*

**Dhiaku:** *(me zë të ulët)* Le t'i lutemi Zotit. Mëshiro, o Zot.

*Prifti, duke ulur kryet thotë uratën e hyrjës:*

**Prifti:** *(me zë të ulët)* Në mbrëmje, në mëngjes dhe në drekë, të lavdërojmë, të bekojmë, të falenderojmë dhe të lutemi, o Zot i të gjithave, Zot njeridashës. Drejtoje faljen tonë si temjam përpara teje, dhe mos i ler zemrat tona të rrëshqasin në fjalë ose në mendime të këqia, por shpëtona nga gjithë ata që gjuajnë shpirtat tanë; se tek Ti, o Zot, o Zot, janë sytë tanë dhe më Ty shpresuam; mos na turpëro, o Perëndia ynë. Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Pastaj, pasi dhiaku thotë:*

Beko o Zot hyrjen e shenjtë.

*Prifti duke bekuar hyrjen thotë:*

*(pa zë)* E bekuar është hyrja e shenjtoreve të tu, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Dhiaku (ose prifti) pasi temjanis nga Lindja në formë kryqi, ose në rast të kremeje ngre Ungjillin e Shenjtë, e thotë:*

**Dhiaku:** *(më zë të lartë)* Urtësi. Drejt.

*Hyjnë që të dy në hierore dhe dhiaku temjanis altarin e shenjtë, ndërsa Anagnosti thotë:*

**Anagnosti:** O Iisu Krisht, dritë gazmore e lavdisë së shenjtë të Atit të pavdekshëm, qiellor, të shenjtë e të lumtur, si arritëm në perëndimin e diellit dhe pamë dritën e mbrëmjes, himnojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Perëndinë. Ti meriton në çdo kohë të himnoshesh me zëra të mbara, o Bir i Perëndisë, që jep jetë, prandaj bota të lavdëron.

*Pas kësaj:*

**Dhiaku:** Mbrëmje.

**Anagnosti:** Paravarg. Tingull... Psalm...

*Dhe thotë me zë Paravargun dhe vargun e vet.*

**Dhiaku:** Urtësi.

**Anagnosti:** Lexim nga Gjeneza (*ose* nga Eksodi).

**Dhiaku:** Le të vëmë re.

*Dhe Anagnosti lexon tërë pjesën e parë të Gjenezës ose të Eksodit dhe në vazhdim tërë Paravargun dhe vargun e Leximit II, pas të cilit thotë me zë më të theksuar e melodioz:*

**Anagnosti:** Urdhëro!

*Prifti, duke mbajtur në dorën e djathtë një llambadhë të ndezur dhe temjanicën të varur, qëndron para Tryezës së Shenjtë dhe duke bërë shenjën e Kryqit me llambadhën, thotë:*

**Prifti:** (*me zë*) Urtësi. Drejtë.

*Pastaj prifti, duke qëndruar te Solea dhe duke parë nga ikona e Krishtit, thotë:*

**Prifti:** Drita e Krishtit,

*Dhe duke u kthyer nga populli:*

**Prifti:** u ndrit të gjithëve.

*Dhe duke bekuar në formë kryqi me llambadhën, kthehet në hierore duke i dorëzuar shërbyesit llambadhën dhe temjanicën.*

*Pastaj anagnosti:*

**Anagnosti:** Lexim nga Proverbat (*ose* nga Jovi)

**Dhiaku:** Urtësi. Le të vëmë re.

*Anagnosti lexon pjesën e dytë nga Proverba ose nga Jovi që i përket ditës.*

*Pas plotësimit të leximit II, prifti bekon anagnostin e thotë:*

**Prifti:** Paqe më ty.

**Dhiaku:** Urtësi.

*Prifti, duke qëndruar para Tryezës së Shenjtë dhe duke temjanisur lehtë, psal me shpresëtari e hijeshi (javën e parë të kreshmëve dhe javën e Madhe si edhe po të qëllojë e kremtja e ndonjë shenjti, ngadalë në ting. Tërth. II, kurse në meshat e të Parshenj-tëruarave, më të shpejtë në Ting. Tërth. I), pjesën «Le të drejtohet...».*

**Prifti:** Le të drejtohet lutja ime si temjam përpara tejë ngritja e duarve të mia si therore e mbrëmshme.

*Pastaj e përsërisin këtë në të njëjtin tingull psaltët, herë njëri, herë tjetri, katër herë duke qëndruar më këmbë poshtë froneve, kurse prifti në çdo «Le të drejtohet» temjanis çdo anë të Tryezës së Shenjtë duke thënë vargjet e mëposhtme:*

**Prifti:** O Zot, thirra te Ty, dëgjomë, dëgjomë, o Zot. O Zot, thirra te Ty, dëgjomë, vëri re zërit të lutjes sime; kur thërres te Ty.

**Psaltët:** Le të drejtohet lutja ime...

**Prifti:** Vëri roje gojës sime, o Zot; dhe derë si gardh buzëve të mia.

**Psaltët:** Le të drejtohet lutja ime...

**Prifti:** Mos ma ler zemrën të rrëshqasë në fjalë të këqia për të arsyetuar mëkatet.

**Psaltët:** Le të drejtohet lutja ime...

*Dhe kështu prifti arrin te këndi i parë, domethënë para Tryezës së Shenjtë dhe përsërit duke psalur:*

**Prifti:** Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.  
Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Psaltët:** Le të drejtohet lutja ime...

**Prifti:** Le të drejtohet lutja ime,

*Dhe si del te Dera e Bukur, temianis ikonën e Zotit Krisht duke psalur:*

**Prifti:** si temjam përpara teje;

*Pastaj vazhdon duke temjanisur edhe ikonat e tjera, kishën dhe popullin, kurse psaltët plotësojnë duke psalur pjesën që mbetet:*

**Psaltët:** Ngritja e duarve të mija, si therore e mbrëmbshme.

*Të gjithë sa janë në kishë, bëjnë tri metani të mëdha.*

\*

*Pastaj, në rast se përkujtohet ndonjë shenjt, lexohet, para se të thuhet Lutja e gjerë, Apostulli dhe Ungjilli sipas rregullit, kurse në të tri ditët e para të Javës së Madhe, lexohet vetëm Ungjilli. Në këto raste prifti lexon me zë të ulët uratën e Ungjillit:*

**O Zot, njeridashës,** (fq. 92), dhe ndërkohë dhiaku temjanis.  
*Pastaj dhiaku thotë: «Beko, o Zot, ...» etj. atë që lexon Ungjillin... etj. si në meshën hyjnore të Gojartit (fq. 93).*

\*

*Pastaj që të dy, prifti dhe dhiaku, bëjnë tre metani dhe mbyllet Dera e Bukur:*

*Dhiaku, si del nga hierorja (ose prifti duke qëndruar përpara Derës së Bukur), thotë Lutjen e gjerë:*

- Dhiaku:** Le të themi të gjithë, me tërë shpirtin dhe me tërë mendjen tonë, le të themi.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** O Zot i gjithëpushtetshëm, Perëndia i etërve tanë, të lutemi, dëgjo e mëshiro.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** Mëshirona, o Perëndi, sipas mëshirës sate të madhe, të lutemi, dëgjo e mëshiro.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** Lutemi edhe për të krishterët shpresëtarë dhe orthodhoksë.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** Lutemi edhe për Kryepiskopin (ose episkopin) tonë (*aksh*).
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** Lutemi edhe për vëllezërit tanë: priftërinjtë, ieromonakët, ierodhiakonët, monakët dhe për tërë vëllazërinë tonë më Krishtin.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** Lutemi dhe për mëshirë, jetë, paqe, shëndet, shpëtim, vështrim, ndjesë dhe falje të mëkateve të shërbëtorëve të Perëndisë, gjithë të krishterëve shpresëtarë dhe orthodhoksë, që banojnë dhe ndodhen në këtë qytet (*ose* manastir), enoritëve, epitropëve dhe ndihmëtarëve të kësaj shtëpie të shenjtë.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).
- Dhiaku:** Lutemi edhe për të lumturit dhe gjithmonëkujtueshmit themelues të kësaj shtëpie të shenjtë dhe për tërë etërit dhe vëllezërit tanë të parafjetur, orthodhoksë që prehen me shpresë këtu e kudo.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

**Dhiaku:** Lutemi dhe për ata që sjellin pemë dhe bëjnë punë të mira në këtë kishë të shenjtë dhe të gjithënderuar, që mundohen, që psalin dhe për popullin që qëndron rrotull, dhe pret prej Teje mëshirën e madhe dhe të pasur.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

*Në kohën që dhiaku thotë Lutjen e gjerë, prifti lexon:*

**Prifti:** (*pa zë*) O Zot Perëndia ynë, prit këtë lutje të gjërë të shërbëtorëve të tu dhe mëshirona sipas mëshirës sate të shumtë; dhe dërgo dhëmbshuritë e tua mbi ne dhe mbi tërë popullin tënd, i cili pret prej teje mëshirën e pasur.

(*me zë të lartë*) Se Ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Dhiaku:** Lutjuni Zotit, ju katikumenët.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Ne besimtarët le të lutemi për katikumenët.  
Që t'i mëshirojë Zoti.  
Që t'u mësojë fjalën e së vërtetës.  
Që t'u zbulojë Ungjillin e drejtësisë.  
Që t'i bashkojë me Kishën e shenjtë, të përgjithshme dhe apostolike.  
Shpëtoi, mëshiroi, përkrahi dhe ruaji, o Perëndi, me hirin tënd.  
Ju katikumenë, kryet tuaj uljani Zotit.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

*Në kohën që dhiaku thotë të mësipërmet, prifti lexon uratën e katikumenëve, para se të hapet Andiminsi:*

**Prifti:** (*pa zë*) O Perëndi, Perëndi ynë, krijuesi dhe bërësi i të gjithave, Ti që do të shpëtojë të gjithë dhe të njohin

të vërtetën tënde, shtjer sytë mbi shërbëtorët e tu katikumenë dhe shpëtoi prej rrejtjes së vjetër dhe prej dredhivë të kundërshtarit; thirri këta në jetën e përjetshme, duke ndriçuar shpirtrat e trupat e tyre dhe duke i radhitur në grigjën tënde shpirtërore, për të cilën thërritet në ndihmë Shpirti yt i Shenjtë.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Që dhe ata bashkë me ne të lavdërojnë emrin tënd të gjithënderuar dhe madhështor, të Atit, e të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

*Ndërkaq prifti merr Ungjillin e Shenjtë dhe bën me të shenjë e Kryqit mbi Andiminsin, të cilin pastaj e shtrin mbi Tryezën e Shenjtë, kurse Ungjillin e vendos në pjesën e sipërme të tij.*

**Psaltët:** Amin.

**Dhiaku:** Sa jeni katikumenë, shkoni. Ju katikumenë, shkoni. Sa jeni katikumenë, shkoni. Asnjë nga katikumenët të mos qëndrojë. Sa janë besimtarë, përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

*Këto thuhën vetëm gjer të martën e javës IV dhe menjëherë prifti thotë uratën që pason për besimtarët: O Perëndi i madh dhe i lavdishëm...*

---

*Kurse nga e Mërkura e javës IV të Kreshmëve e cila quhet dhe «Gjysmëkreshmë» e gjer te e Mërkura e Madhe, në meshat e parashenjtëruara, pasi të thuhet: «Që edhe ata bashkë me ne të lavdërojnë...», shtohet edhe lutja për katekumenët që përgatiten për Pagëzimin hyjnor që është:*

**Dhiaku:** Sa jeni katikumenë, shkoni. Ju katikumenë, shkoni. Sa jeni për ndriçim, shkoni. Ju që jeni për ndriçim, lutjuni Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Besimtarë, për vëllezërit që përgatiten për ndriçim dhe për shpëtimin e tyre, le t'i lutemi Zotit.

- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Që Zoti Perëndia ynë t'i mbajë ata dhe t'i forcojë, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** T'i ndriçojë me dritën e dijes dhe të shpresëtarisë, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** T'i bëjë të denjë në kohën e duhur për banjën e rilindjes, për ndjesën e fajeve dhe për rroben e mosprishjes, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** T'i rillindë me ujë dhe Shpirt, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** T'u dhurojë besën e përsosur, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** T'i radhitë në grigjën e Tij të shenjtë dhe të zgjedhur, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Përkrahi, shpëtoi, mëshiroi dhe ruaji, o Perëndi, me hirin tënd.  
Ju që jeni për ndriçim, kryet tuaj uljani Zotit.
- Psaltët:** Ty, o Zot.

*Uratë për ata që përgatiten për ndriçim:*

- Prifti:** *(pa zë)* Shfaqiq, o Zot, fytyrën tënde, atyre që përgatiten për ndriçimin e shenjtë dhe dëshirojnë të hedhin tej ndyrësinë e mëkatit; ndriçoja mendjen, forcoi në besë, mbështeti në shpresë, bëji të përsosur në dashuri; tregoi pjesëtarë të nderuar të Krishtit tënd, i cili dha veten si shpërblim për shpirttrat tanë.

*(me zë të lartë)* Se Ti je ndriçimi ynë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit, e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Dhiaku:** Sa jeni për ndriçim, dilni. Ju për ndriçim, dilni. Sa jeni katikumenë, dilni.  
Ansje nga katikumenët të mos mbetet. Sa jeni besimtarë, përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit. Përkrana, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd. Urtësi.

*Gjer këtu, ato që thuhet që nga e merkura e «Gjysmëkreshmëve».*

---

*Prifti thotë uratën e parë të besimtarëve:*

**Prifti** *(pa zë)* O Perëndi i madh dhe i lavdëruar, që me vdekjen jetëbërëse të Krishtit tënd, na shpurre prej prishjes në mosprishje, Ti, dhe tërë ndjenjat tona çliroi nga vdekja që shkaktojnë pasionet; duke vënë mbi to si udhëheqës të mirë arsyen e brendshme: Syri ynë u largoftë prej çdo vështrimi dinak, veshi ynë mos dëgjoftë fjalë të këqia, dhe gjuha jonë qoftë e pastër nga fjalë të papërshtatshme. Pastro buzët tona që të të lavdërojnë, o Zot; bëj që duart tona të largohen nga veprat e liga dhe të bëjnë vetëm ato që janë të pëlqyera përpara teje, duke forcuar me hirin tënd gjithë pjesët e trupit tonë dhe mendjen.

*(me zë të lartë)* Se Ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit, e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd. Urtësi.

*Prifti thotë uratën e dytë të besnikëve:*

**Prifti:** *(pa zë)* O Zot i shenjtë, tepër i mirë, të lutemi Ty që je i pasur në mëshirë, rrëfegu i mëshirshëm për ne mëkatarët dhe bëna të denjë të presim Birin tënd të vetëmlindur edhe Perëndinë tonë, mbretin e lavdisë; se ja Trupi i tij i kulluar dhe Gjaku i tij jetëbërës tek po sillen në këtë orë brenda dhe do të vihen mbi këtë tryezë mistike, të rrethuara në mënyrë të padukshme prej një ushtrie të shumtë qiellore, kungimin e të cilave dhurona pa dënim; që duke u ndriçuar me këto syri i mendjes sonë, të bëhemi bij drite dhe dite.

*(me zë të lartë)* Sipas dhuratës së Krishtit tënd, me të cilin je i bekuar bashkë me Shpirtin tënd të tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Dhiaku hyn nga Dera e jugut brenda në hierore dhe qëndron afër priftit.*

*Urata e himnit keruvik nuk thuhet.*

*Psaltët në vend të himnit keruvik psalin:*

**Psaltët:** Tani fuqitë qiellore, bashkë me ne padukurisht meshojnë. Se ja tek hyn mbreti i lavdisë.

*Prifti, duke qëndruar përpara Tryezës së shenjtë, përkulet tri herë edhe thotë edhe ai (tri herë):*

**Prifti:** *(pa zë)* Tani fuqitë qiellore, bashkë me ne padukurisht meshojnë. Se ja tek hyn mbreti i lavdisë.

**Dhiaku:** Ja therore mistike e kryer po vjen rreth. Me besë e me dashuri le të afrohemi që të bëhemi pjesëtarë të jetës së përjetshme. Aliluia *(tri herë)*.

*Gjatë kohës që psalet himni keruvik prifti bekon temjanicën, si zakonisht, dhe menjëherë temjanis Tryezen e shenjtë, Proskomidhinë e shenjtë dhe gjithë priftërinjtë, duke thënë pa zë «Ejani t'i falemi...» (tri herë) dhe psalmin 50, «Mëshiomë, o Perëndi, ...» deri në vargun «Atëherë do të të pëlqejë therore drejtësie...». Edhe pasi hap Derën e Bukur temjanis ikonat e shenjta, kishën edhe gjithë popullin. Pasi kthehet në hierore, dorëzon temjanicën, përkulet me dhiakun, del në Derën e Bukur dhe, pasi merr ndjesë nga popullit vjen në Proskomidhi dhe e temjanis duke u përkulur tri herë, dhe thotë: «O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiomë».*

*Në këtë kohë, brenda heshtjes së thellë, dhe duke qenë të gjithë të rënë më gjunjë gjer në tokë, dalin nga Dera e veriut: Dhiaku me llambadhë dhe temjanicë temjanis pa zhurmë; prifti duke mbajtur Ajrin mbi krye dhe duke mbajtur me dorën e tij të dhjathtë Dhiskun e shenjtë mbi krye dhe me të majtën Potirin e shenjtë, pa asnjë fjalë veç «Me urarat të Etërve tanë, o Zot Iisu Krisht, Perëndia ynë, mëshirona dhe shpëtona. Amin.» Dhe hyjnë drejt nëpërmjet Derës së Bukur në hierore, dhe mbyllet Dera e Bukur, e cila hapet vetëm kur thuhet «Me frikë Perëndie». Dhe duke vendosur të Shenjtat mbi Tryezën e shenjtë, heq prej tyre mbulesat dhe i mbulon ato me Ajrin.*

**Dhiaku:** Bëje të mirë, o Zot.

*Prifti merr temjanicën dhe temjanis të Shenjtat tre herë, duke thënë:*

Atëherë do të sjellin viça mbi altarin tënd, dhe mëshiomë, o Perëndi.

**Psaltët:** Ja therore mistike e kryer po vjen rreth. Me besë e me dashuri le të afrohemi që të bëhemi pjesëtarë të jetës së përjetshme. Aliluia, Aliluia, Aliluia.

*Prifti falet tri herë para Tryezës së shenjtë dhe uth të Shenjtat.*

*Pastaj dhiaku i thotë priftit:*

Falu për mua, o Zot i shenjtë.

*Dhe prifti i përgjigjet:*

Shpirti i Shenjtë do të vijë mbi ty dhe fuqi e të Lartit do të të hijesojë.

*Dhe menjëherë dhiaku thotë:*

Vetë Shpirti do të bashkëmeshojë me ne, tërë ditët e jetës sonë.

*Dhe përsëri Dhiaku:*

Kujtomë, o Zot i Shenjtë.

**Prifti:** Dhiakoninë tënde e kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e Tij, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

*Dhe dhiaku, pas Amin-it, si puth dorën e priftit, del nga hierorja, qëndron në vendin e zakonshëm dhe thotë Lutjen e gjerë:*

**Dhiaku:** Le ta plotësojmë lutjen tonë të mbrëmjes ndaj Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Për Dhurarat e çmuara, të parashenjtëruara dhe të vëna përpara, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Që Perëndia ynë njeridashës, i cili i pranoi ato si aromë shpirtërore në altarin e tij të shenjtë, qiellor dhe të kuptuar me anë të mendjes, të na dërgojë si shpërblim hirin hyjnor dhe dhuratën e Shpirtit të Shenjtë, le të lutemi.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

- Dhiaku:** Mbrëmjen të tërë të përsosur, të shenjtë, me paqe dhe të pamëkatshme, le t'ia lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Engjëll paqeje, udhëheqës besnik, ruajtës të shpirtave dhe të trupave tanë, le t'i lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Ndjesë dhe falje të mëkateve dhe të fajeve tona, le t'i lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Të mirat dhe të dobishmet për shpirtat tanë dhe paqe për botën, le t'i lypim Zotit.
- Psaltët:** Falna, o Zot.
- Dhiaku:** Që të kalojmë në paqe dhe në pendim jetën që na mbetet, le t'i lypim Zotit.
- Psaltët:** Mbarim të krishterë të jetës sonë, pa dhimbje, faqebardhë, me paqe dhe mbrojtje të mirë përpara gjykatores së trembshme të Krishtit, le të lypim.
- Dhiaku:** Duke lypur bashkimin e besës dhe pjesëmarrjen e Shpirtit të Shenjtë, veten tonë dhe njëri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë Krishtit Perëndisë le t'ia parashtrojmë.
- Psaltët:** Ty, o Zot.
- Prifti duke u përkulur lutet:*
- Prifti:** *(pa zë)* O Perëndi i mistereve që s'mund të tregohen e s'mund të shihen, pranë të cilit janë thesaret e fshehtë të urtësisë e të diturisë; që na zbulove shërbimin e kësaj meshë dhe na vure ne mëkatarët nga njeridashja jote e shumtë, që të të sjellim dhurata e therore për mëkatet tona dhe për fajet e popullit të bëra nga padija; Ti o mbret i padukshëm, që bën vepra të mëdha e të pagjurmueshme, të lavdërueshme dhe të çuditshme, të cilat

s'kanë numër, hidh syrin tënd mbi ne shërbëtorët e tu të padenjë, që qëndrojmë përpara këtij Altarit tënd të shenjtë, si përpara fronit tënd keruvik, mbi të cilin Biri yt i vetëmlindur dhe Perëndia ynë prehet me anën e këtyre mistereve të frikshme që i janë vënë përpara; dhe duke na çliruar ne dhe popullin tënd besnik prej çdo ndyrësie, shenjtëro trupat dhe shpirtat e të gjithë neve me shenjtërim që s'mund të na merret; që duke patur ndërgjegje të pastër, fytyrë të paturpëruar, zemër të ndritur, të kungohemi me këto Dhurata hyjnore dhe të shenjtëruara, dhe, duke marrë jetë prej tyre, të bashkohemi me vetë Krishtin tënd, Perëndinë tonë të vërtetë, që tha: «Ai që ha trupin tim e pi gjakun tim, mbetet tek unë edhe unë tek ai»; që duke ndenjur e duke jetuar ndër ne Fjala jote, o Zot, të bëhemi tempull i Shpirtit tënd të tërëshenjtë e të adhuruar, të çliruar prej çdo dredhie djallëzore që bëhet me vepra, me fjalë a me mendje dhe të fitojmë mirësitë e tua të zotuara, bashkë me gjithë shenjtoret e tu, që të kanë pëlqyer që prej jetë.

*(me zë të lartë):* Dhe bëna të denjë, o Zot, që pa drojtje e pa dënim të guxojmë të të thërresim Atë, Ty, Perëndinë qiellore e të themi:

*Anagnosti ose psalti thonë bashkë me gjithë popullin uratën Zotërore:*

**Anagnosti:** Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Se jotja është mbretëria, dhe fuqia, dhe lavdia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Prifti:** Paqe në të gjithë.

**Psaltët:** Dhe në shpirtin tënd.

**Dhiaku:** Kryet tanë le t'ia ulim Zotit.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

*Prifti thotë këtë uratë:*

**Prifti:** *(pa zë)* O Perëndi, i vetëm, i mirë, dhe i dhembshur, që rri në të lartat dhe kqyr ato që ndodhen poshtë, vështro me sy të dhembshur tërë popullin tënd dhe ruaje atë, dhe bëna të denjë të gjithë ne, të marrim pjesë pa dënim në këto misteret e tua jetëbërëse; se përpara teje kemi ulur kryet tanë duke përitur mëshirën tënde të pasur.

*Prifti duke ngritur Yllin thotë:*

*(me zë të lartë)* Me hirin dhe dhëmbshuritë dhe njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin tënd të tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Prifti duke u përkalur thotë këtë uratë:*

**Prifti:** *(pa zë)* Vër re, o Zot Iisu Krisht Perëndia ynë, nga banesa jote e shenjtë dhe nga froni i lavdisë së mbretërisë sate, dhe eja të na shenjtërosh, Ti që rri lart bashkë me Atin dhe që je këtu padukurisht bashkë me ne; dhe me dorën tënde të fuqishme na bëj të denjë që të na japësh Trupin tënd të pacënuar dhe Gjakun tënd të çmuar dhe me anën tonë gjithë popullit.

*Pas uratës falet 3 herë duke thënë me vete:*

O Perëndi, të ardhhtë keq për mua mëkatarin dhe mëshiromë.

*Dhiakoni, duke qëndruar jashtë thotë:*

**Dhiaku:** *(me zë të lartë)* Le të vëmë re.

*Prifti, duke qenë të mbuluara Dhuratat e Shenjta, fut duart, prek Bukën jetëbërëse dhe me shpresëtari e frikë të shumtë, pa e ngritur plotësisht atë thotë:*

**Prifti:** Të Shenjtat e parashenjtëruara të shenjtëve.

**Psaltët:** Një është Shenjt, një është Zot, Iisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

*Dhe menjëherë këndohet qinonikoja:*

**Psaltët:** Shijoni dhe shihni se Zoti është i mirë. Alilua, Alilua, Alilua.

*Kur takon e kremte e ndonjë shenjt, psalet ky himn:*

I drejti do të kujtohet për jetë.


*Në këtë kohë dhiaku hyn brenda në hierore dhe pasi prifti zbulon të Shenjtat, dhiaku thotë:*

**Dhiaku:** Copëto, o Zot, Bukën e shenjtë.

*Prifti e copëton në katër pjesë me kujdes dhe shpresëtari, duke thënë:*

**Prifti:** Copëtohet dhe pjesëtohet Qengji i Perëndisë, i cili copëtohet dhe nuk përndahet, i cili hahet gjithnjë dhe nuk mbarohet kurrë, por shenjtëron ata që kungohen.

*Prifti i rregullon të katër pjesët e Bukës mbi Dhiskun e shenjtë në formë kryqi:*



*Dhe dhiaku, duke treguar Potirin e Shenjtë, thotë:*

Mbush, o Zot, Potirin e Shenjtë.

*Dhe prifti, si merr meridhën e sipërme të Qëngjit që ka shkronjat  
bën me të shenjëën e kryqit mbi Potirin (nga njëra buzë  
në tjetrën) thotë:*

Mbushja e Potirit me Shpirt të Shënjtë.

*Dhe e vendos atë brenda në Potirin e Shenjtë.*

*Dhiakoni thotë:* Amin.

*Dhe si merr ujin e nxehtë, i thotë priftit:*

Beko, o Zot, Ujët e nxehtë.

*Prifti e bekon duke thenë:*

E bekuar është nxehtësia e shenjtoreve të tu, gjithnjë;  
tani e përherë e në jetë të jetëve.

*Dhiaku, duke mbajtur me kujdes, me dorën e majtë, Potirin  
e shenjtë, derdh ujin e nevojshëm në Potir në formë kryqi.*

*Dhe prifti thotë:*

Nxehtësi e besës, plot me Shpirtin e Shenjtë.

**Dhiaku:** Amin.

*Dhe si vendos enën me Ujin e nxehtë në vendin e saj, qëndron  
pak më lart duke u falur me vete.*

*Kurse prifti kokulur lexon me shpresë këto urata para kungimit:*

Besoj, o Zot, dhe pohoj se Ti je me të vërtetë Krishti,  
Biri i Perëndisë së gjallë që erdhe në botë të shpëtosh  
mëkatarët, nga të cilët i pari jam unë. Gjithashtu besoj  
se ky është vetë trupi yt i pacenuar dhe ky është vetë  
gjaku yt i çmuar. Të lutem pra, mëshiromë dhe falmi  
fajet, të bëra me dashje dhe pa dashje, me fjalë, me punë,  
me dije dhe padije dhe bëmë të denjë që të marr pjesë  
pa dënim në misteret e tua të pacënuara për ndjesën e  
mëkateve dhe për jetën e amëshuar. Amin.

*Pastaj thonë këto vargje:*

Ja tek po shkoj për Kungatën hyjnore,  
O krijues, mos më digj me anën e kungatës,  
Se ti je zjarr që djeg të padenjët.  
Por pastromë prej çdo njolle.

Në darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t'ua them armiqve të tu misterin; nuk do të të jap të puthur si Juda; por duke të pohuar si kusari, thërres: Kujtomë, o Zot, në mbretërinë tënde.

O njeri, dridhu, duke parë Gjak hyjnizues.  
Se është thëngjill që djeg të padenjët;  
Trupi i Perëndisë, dhe më hyjnizon dhe më ushqen;  
Shpirtin e hyjnizon dhe mëndjen e ushqen çuditërisht.

Më ngazëllove me mallin tënd, o Krisht, dhe më ndryshove me dashurinë tënde hyjnore; po digji me zjarr të palëndshëm mëkatet e mia dhe bëmë të denjë të nginjem me ëmbëlsirën tënde, që duke kërcyer të madhëroj, o i Mirë të dyja adhjet e tua.

Ndër shkëlqimet e shenjtorëve të tu si do të hyj unë i padenji? Se në guxofsha të hyj bashkë në nusërorem, rroba më tregon se s'është e dasmës, dhe i lidhur do të nxirrem jashtë prej engjëjve. Pastro, o Zot, ndyrësinë e shpirtit tim dhe shpëtomë si njeridashës.

*Pastaj këtë urate:*

O Zot njeridashës, Zoti Iisu Krisht, Perëndia im, të mos jenë këto për dënimin tim këtë të Shenjtat pasi jam i padenjë, por për pastrim dhe shenjtërim të shpirtit dhe të trupit dhe për sigurim të jetës dhe mbretërisë së ardhshme. Për mua është mirë t'i ngjitem Perëndisë dhe të ve te Zoti shpresën e shpëtimit tim.

*Dhe përsëri:*

Në darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar, se nuk do t'ua them armiqve të tu misterin; nuk do të të jap të puthur si Juda, por duke të pohuar si kusari, thërres: Kujtomë, o Zot, në mbretërinë tënde.

*Pastaj prifti duke ardhur që të kungohet, i thotë dhiakut:*

O vëlla dhe bashkëmëshëtar, ndjemë mua priftin e padenjë.

*Dhe dhiaku përgjigjet:*

Priftërinë tënde e kujtoftë Zoti Perëndia në mbretërinë e Tij, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

*Pastaj, prifti thotë:*

O Perëndi, falmë mua mëkatarin dhe mëshiromë (*tri herë*).

*Dhe si u afrohet të Shenjtave me frikë dhe shpresë, merr një pjesë nga Trupi i shenjtë, nga pjesa që ka shkronjat IS dhe thotë:*

Ja tek vij te Krishti, mbreti i pavdekshëm dhe Perëndia ynë.

Trupi i çmuar dhe i tërëshenjtë, i Zotit Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, më jepet mua priftit të padenjë (*aksh*) për ndjesën e mëkateve të mia dhe për jetën e amëshuar.

*Dhe si kungohet, thotë:*

Amin.

*Pastaj i thotë dhiakut:*

Dhiak, afrohu.

*Dhiaku duke ardhur dhe duke hapur duart në formë kryqi, duke pasur pëllëmbën e djathtë mbi të majtën, thotë:*

**Dhiaku:** Ja tek vij te Krishti, Mbreti i pavdekshëm dhe Perëndia ynë.

Jepmë, o Zot, Trupin e çmuar dhe të shenjtë të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, mua dhia-  
kut të pandenjë (*aksh*) për ndjesën e mëkateve të mia  
dhe për jetën e amëshuar.

*Prifti duke i dhënë një pjesë nga Trupi i shenjtë, thotë:*

**Prifti:** Të jepet, ty (*aksh*) dhiaikut shpresëtar Trupi i çmuar dhe i shenjtë i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Iisu Krisht, për ndjesën e mëkateve të tua dhe për jetën e amëshuar.

**Dhiaku:** Amin.

*Dhe dhiaku, pasi puth dorën e priftit, merr Bukën e shenjtë, shkon prapa Tryezës së hirshme dhe, duke ulur kryet, kungohet. Këtë e bëjnë edhe priftërinjtë ose dhiakonët e tjerë kur bashkë-meshojnë.*

*I pari i pritërinjve, pasi të jetë kunguar me Trupin e çmuar, ia jep atë edhe dhiakut.*

*Pastaj prifti merr mbulesën dhe ai e mbështet mirë te nofulla e tij, merr me të dy duart dhe me mbulesën Potirin e shenjtë dhe thotë:*

Gjithashtu më jepet mua (*aksh*), priftit të padenjë, Gjaku i çmuar dhe i tërëshenjtë i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Iisu Krishtit, për ndjesë mëkatesh dhe jetë të pasosur.

*Dhe kungohet tri herë, pa thënë gjë, fshin mirë buzët e tij dhe buzët e Potirit të shenjtë me Mbulesën që mban në dorë; e ngre Potirin lart, e puth edhe thotë:*

Ky preku buzët e mia, dhe Zoti do të më heqë gjithë paudhësitë dhe do të më pastrojë nga mëkatet.

*Dhe fton dhiakun duke thënë:*

Dhiak, afrohu përsëri.

*Dhe dhiaku vjen para Tryezës së Shenjtë, fshin pëllëmbën mbi Dhiskun dhe thotë me vëmendje:*

Jepmë, o Zot mua (*aksh*), dhiakut të padenjë Gjakun e çmuar dhe të tërëshenjtë të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Iisu Krishtit, për ndjesë mëkatesh dhe jetë të pasosur.

*Dhe prifti e kungon atë tri herë me Potirin duke thënë:*

Të jepet, ty (*aksh*) dhiaku shpresëtar, Gjaku i çmuar, dhe i Tërëshenjtë i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Iisu Krishtit, për ndjesë të mëkateve të tua dhe për jetë të pasosur. Amin.

*Pastaj, si pastron edhe ky me mbulesën buzët e veta e të Potirit të Shenjtë, puth Potirin:*

*Dhe prifti, duke ngritur Potirin lart, thotë:*

Ky preku buzët e tua dhe Zoti do të falë gjithë paudhësitë e tua e do të pastrojë mëkatet e tua.

*Kështu bëjnë dhe priftërinjtë dhe dhiakonët e tjerë kur bashkë-meshojnë.*

*Pastaj dhiaku merr Dhiskun e shenjtë me dorën e majtë dhe me të dy gishtërinjtë e dorës së djathtë sfungjerin dhe hedh pjesët e Trupit të Shenjtë (pjesët me gërmat KR, FI dhe TON), të cilat i ndan në pjesë të vogla kur ka për të kunguar besimtarët, në Potirin e Shenjtë me kujdes duke thënë:*

Ne që pamë ngjalljen e Krishtit, le t'i falemi të shenjtit, Zotit Iisu, të vetmit të pamëkatshëm, Kryqit tënd po i falemi o Krisht dhe ngjalljen tënde të shenjtë himnojmë dhe lavdërojmë, se ti je Perëndia ynë, veç teje nuk njohim tjetër, emrin tënd përmendim. Ejani gjithë besnikët t'i falemi ngjalljes së shenjtë të Krishtit. Se ja tek erdhi me anën e Kryqit gëzim në tërë botën. Duke bekuar kurdoherë

Zotin, himnojmë ngjalljen e Tij, se duke duruar kryqin për ne, me vdekje vdekjen e zhduku.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri, se lavdia e Zotit lindi përmbi ty. Vallëzo tani dhe ngazëllohu, o Sion, dhe ti o Hyllindëse e kulluar, dëfre me ngjalljen e Birit tënd.

O zëri yt i hyjshëm, i dashur edhe fort i ëmbël, se me të vërtetë u zotove të jesh bashkë me ne gjer në mbarim të jetës, o Krisht, të cilin zë duke e patur ne besnikët me ne gjer në mbarim të jetës, o Krisht, të cilin zë duke e patur ne besnikët si ankurë shprese, ngazëllohemi.

O Krisht, Pashkë e madhe dhe fort e hirshme, o urtësi dhe Fjalë dhe fuqi e Perëndisë; jepna që më qartë të marrim pjesë me ty në ditën e paperënduar të Mbretërisë sate.

*Kur prifti ka për të kunguar besimtarët, nuk duhet t'i shtjerë pjesët e tjera, por vetëm pjesët që përfaqësojnë Trupin e Zotit; dhe si të kungojë besimtarët i shtie dhe pjesët e tjera, duke thënë:*

Laji, o Zot, mekatët e shërbëtorëve të tu që u kujtuan këtu me Gjakun tënd të shenjtë, me ndërmjetimet e Hyjllindëses dhe të gjithë shenjtorëve të tu.

*Si të ketë fshirë mirë Dhiskun e shenjtë, merr në formë kryqi, katër cepat e Andiminsit të shenjtë, dhe i mban me dorën e majtë; kurse me anën të dorës së djathtë merr pjesën e poshtëme të Andiminsit që varët dhe e shkund atë. Pastaj e hapë Andiminsin dhe, me anën të Lugës së shenjtë mbledhë therimet dhe i hedh në Potirin e shenjtë. Pastaj vendos vetëm Yllin mbi Dhiskun e shenjtë dhe mbi Yll vendos Mbulesat.*

*Prifti, pasi të këtë venë Lugën e shenjtë brenda në Potirin e shenjtë, ngre Potirin e shenjtë dhe ia jep dhiakut, i cili falet një herë; dhe si hapë Derën e Bukur prifti dhe kthehet drejt perëndimit (nga populli), dhiaku thote:*

**Dhiaku:** Me frikë Perëndie, besë dhe dashuri, afrohuni.

**Psaltët:** *(pa psalur)* Amin. I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit. Perëndi është Zoti dhe u çfaq nër ne.

*Dhe bëhet kungimi i atyre që deshirojnë të kungohen. Nëse janë besimtarë që duan të kungohen, prifti merr nga duart e dhiakonit Potirin e shenjtë dhe i kungon duke i thënë secilit:*

**Prifti:** Trup dhe Gjak Krishti.

*Për kungimit të besimtarit të fundit, sthton:*

**Prifti:** Për ndjesë mëkatesh dhe jetë të përjetshme. Amin.

*Në kohën kur prifti kungon besimtarët, psaltët këndojnë në mënyrë recitative një herë apo më shumë herë, sipas numurit të atyre që kungohen, troparin:*

Ne Darkën tënde mistike...

*Si të mbarojë së kunguari, prifti bekon popullin, duke e mbajtur Potirin e shenjtë dhiakoni, e duke thënë:*

*Në kohën kur prifti kungon besimtarët, psaltët këndojnë në mënyrë recitative një herë apo më shumë herë, sipas numrit të atyre që kungohen, troparin:*

Në Darkën tënde mistike...

*Si të mbarojë së kunguari, prifti bekon popullin, duke e mbajtur Potirin e shenjtë dhiakoni, e duke thënë:*

**Prifti:** O Perëndi, shpëto popullin tënd dhe beko trashëgimin tënd.

*Dhe kthehet në Tryëzen e shenjtën:*

**Psaltët:** Në çdo kohë do të bekoj Zotin, lavdërimi i Tij qoftë përgjithmonë në gojën time. Bukë qiellore dhe kupë jetës. Shijoni dhe shihni, se Zoti është i mirë. Aliluia, Aliluia, Aliluia.

*Dhiaku i thotë priftit:*

Ngreje lart, o Zot.

*Prifti temjanis tri herë të Shenjtat, duke thënë me zë të ulët:*

Lartësohu përmbi qiejt, o Perëndi, dhe lavdia jote përmbi tërë dhenë (*tri herë*).

*Dhe si vendos mbi kryet e dhiakut Dhiskun e shenjtë bashkë me të tjerat, dhiaku thotë me zë të ulët:*

Beko, o Zot.

*Dhe shkon në Proskomidhinë e Shenjtë ku i vendos të gjitha.*

*Kurse prifti, si falet, merr Potirin e Shenjtë të mbuluar dhe si thotë pa zë para Tryezës së Shenjtë:*

**Prifti:** *(pa zë)* I bekuar është Perëndia ynë,

*Kthehet nga populli e thotë:*

*(me zë të lartë)*, Gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Prifti e vendos Potirin e shenjtë në Proskomidhinë e shenjtë. Pastaj kthehet në Tryezën e Shenjtë, vendos Sfungjerin në Andimins, të cilin e palos. Palosja bëhet kështu: së pari, paloset pjesa e sipërme, pastaj pjesa e poshtme e më në fund anët: e majta dhe e djathta. Pjesa e sipërme mund të paloset dhe më dysh, që të mos mbulohet ana e jashtme e saj nga e brendshmjia e pjesës së poshtme dhe gjatë palosjes të mos mbe-ten mbi të thërrmia.*

*Pastaj dhiaku del në vendin e zakonshëm para Derës së Bukur e thotë:*

**Dhiaku:** Drejt! Pasi u kunguam me misteret hyjnore, të shenjta, të kulluara, të pavdekshme, qiellore, jetëbërëse dhe të frikshme të Krishtit, siç i meriton, le ta falenderojmë Zotin.

Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Mbrëmjen të tërë të përsosur, të shenjtë, të paqshme dhe të pamëkatshme duke lypur, — vetën tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

*Dhe hyn në Hierore.*

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** Të falenderojmë Ty, Shpëtimtarin dhe Perëndinë e të gjithëve për tërë të mirat që na ke falur edhe për kungimin me Trupin dhe Gjakun e shenjtë të Krishtit tënd. Dhe të lutemi, o Zot njeridashës, ruajna nën mbulesën e kraheve të tu; dhe bëna që deri në pikën e fundit të jetës sonë të marrim pjesë në mënyrë të denjë në të shenjtat e tua, për ndriçim shpirti e trupi dhe për trashëgim të jetës qiellore.

*(me zë të lartë)* Se Ti je shenjtërimi ynë, dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë në jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Këtu prifti merr Ungjillin e Shenjtë, bën me atë shenjë e kryqit mbi Andiminsin e palosur dhe e vendos mbi të me shpresë.*

*Pastaj kthehet nga populli e thotë:*

**Prifti:** Me paqe le të shkojmë.

**Dhiaku:** Le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot *(tri herë)*. Beko, o Zot i shenjtë.

*Prifti thotë uratën të pas amvonit, përpara ikonës së Iisu Krishtit:*

*(me zë të lartë)* O Zot i tërëfuqishëm, që krijove me urtësi tërë krijesën, që me përkujdesjen tënde të patreguar dhe me mirësinë e pasur na bërë të arrijmë këto ditë të shenjta, për të pastruar shpirtat dhe trupat, për të frenuar pasionet, për shpresën në ngjalljen; që, në dyzet ditë, i dorëzove shërbëtorit tënd Moisi dërrasat e shkruara me shkronjat hyjnore, falna dhe neve, o i Mirë, që ndeshjen e bukur ta kryejmë mirë, të kalojmë udhën e kreshmës, të ruajmë besën të pandarë, të dërrmojmë kryet e dragojve të

padukshëm, të tregohemi mundës të mëkatit, dhe të arrijmë t'i falemi Ngjalljes së shenjtë pa dënim. Se i bekuar dhe i lavdëruar është emri yt i nderuar dhe madhështor, i Atit, i Birit dhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Dhiaku bën një përkulje para priftit, hyn në Proskomidinë e shenjtë e rregullon të Shenjtat që kanë mbetur si zakonisht.*

**Psaltët:** *(pa psalur)* Emri i Zotit qoftë i bekuar, që tani e gjer në jetët *(tri herë)*

*Në këtë kohë prifti hyn brenda, shkon në proskomidhi dhe thotë pa zë këtë uratë:*

**Prifti:** *(pa zë)* O Zot Perëndia ynë, që bërë të arrijmë këto ditë të shenjta dhe na tregove pjesëtarë të mistereve të tua të trembshme, bashkona me grigjën tënde shpirtërore dhe tregona trashëgimtarë të mbretërisë sate, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Dhiaku:** Le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

*Prifti qëndron në mes të Derës së Bukur, bekon popullin duke thënë:*

**Prifti:** Bekimi dhe mëshira e Zotit ardhte mbi ju, me hirin e Tij hyjnor dhe njeridashjen, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Prifti:** Lavdi më Ty, o Perëndia, shpresa në, ynë, lavdi më Ty.

**Anagnosti:** Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot *(tri herë)*. Beko, o Zot i shenjtë.

## *Pastaj prifti bën përlëshimin:*

**Prifti:** Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Zonjës sonë të pacenuar, Hyjlindëses dhe gjithmonë Virgjërës Mari; me fuqinë e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës, me mbrojtjet e fuqive qiellore të çmuare dhe pa trup; të nderuarit, të lavdëruarit profet, pararendësit dhe pagëzorit Joan; të Apostujve të shenjtë të lavdëruar dhe të dëgjuar; të Martirëve të shenjtë të lavdëruar e të mëthenj; të Etërve tanë të shenjtë dhe oshënarë; të hyjlprindërve të shenjtë dhe të drejtë Ioaqim dhe Ana; të shenjtit (*të kishës*) dhe të shenjtit (*të ditës*), dhe të gjithë shenjtë na mëshiroftë dhe na shpëtoftë, si i mirë dhe njeridashës.

## *Anagnosti lexon qartë Psalmet:*

### *Psalmi 33*

Do të bekoj Zotin në çdo kohë; lavdërimi i tij do të jetë gjithnjë në gojën time.

Shpirti im do të lavdërohet me Zotin; le të dëgjojnë të butët dhe le të ngazëllohen.

Madhëroni Zotin bashkë me mua dhe bashkë le të lartësojmë emrin e tij. Kërkova Zotin dhe më dëgjoi; dhe nga të gjithë hidhërimet më shpëtoi. Ejani tek ai dhe ndriçohuni; dhe fytyrat tuaja nuk do të turpërohen. I varfëri thirri dhe Zoti e dëgjoi, dhe e shpëtoi nga gjithë hidhërimet e tij. Engjëlli i Zotit do të qëndrojë rreth atyre që ia kanë frikën dhe do t'i shpëtojë.

Shijoni dhe shihni se Zoti është i mirë; lum ai njeri që ka shpresë te ai. Kini frikë nga Zoti, ju, shërbëtorët e tij; se nuk do t'u mungojë gjë atyre që ia kanë frikën.

Të pasur janë varfëruar dhe janë urëturar, po atyre që kërkojnë Zotin nuk do t'u mungojë asnjë e mirë.

Ejani, o bij, dëgjomëni, frikën e Zotit do t'ju mësoj.

Cili është ai njeri që e do jetën dhe dëshiron të shohë ditë të mira? Le të ruajë gjuhën prej së keqes edhe buzët që të mos flasin dredhira. Le të largohet nga e keqja dhe të bëjë të mirën.

Sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e tij janë gati të dëgjojnë lutjet e tyre.

Fytyra e Zotit është kundër atyre që bëjnë keq, ka për të zhdukur prej faqes së dheut kujtimin e tyre.

Thirrën të drejtët dhe Zoti i dëgjo, dhe nga gjithë hidhërimet e tyre i shpëtoi.

Zoti është afër atyre që janë me zemër të thyer; dhe ata që janë me frymë të përvuilur do t'i shpëtojë.

Të shumta janë hidhërimet e të drejtëve; dhe nga të gjitha do t'i shpëtojë Zoti.

Ruan eshtrat e tyre dhe asnjë prej këtyre nuk do të thyhet.

Vdekja e mëkatarëve do të jetë e keqe; dhe ata që urrejnë të drejtin do të bëjnë faj.

Zoti do të shpëtojë shpirtat e shërbëtorëve të tij dhe nuk do të bien në faje gjithë ata që kanë shpresë tek Ai.

### *Psalmi 144*

Do të të lartësoj, o Perëndia im, o Mbreti im, do të bekoj emrin tënd në jetë, e në jetë të jetës.

Përditë do të të bekoj dhe do të të lavdëroj në jetë, e në jetë të jetës. I madh është Zoti dhe fort i lavdëruar; dhe madhëria e tij s'ka fund. Gjithë brezat do të lavdërojnë veprat e tua, edhe fuqinë tënde do ta shpallin.

Do të flasin për madhësinë e lavdisë së shenjtërimit tënd dhe do të tregojnë mrekullitë e tua.

Do të tregojnë fuqinë e veprave të tua të frikshme dhe madhërinë tënde do ta tregojnë.

Do të kujtojnë mirësinë tënde të shumtë, dhe do të ngazëllohen me drejtësinë tënde.

Zoti është i dhembshur dhe i mëshirshëm, zemërgjerë dhe përdëllimadh.

Zoti është i mirë për të gjithë, dhe përdëllimet e tij mbi të gjithë veprat e tij.

Le të të lavdërojnë, o Zot, gjithë veprat e tua, dhe shenjtorët e tu le të të bekojnë.

Do të thonë për lavdinë e mbretërisë sate, dhe do të flasin për fuqinë tënde.

Që bijtë e njerëzve të njohin fuqinë tënde, dhe lavdinë e madhësisë së mbretërisë sate.

Mbretëria jote është mbretëri e gjithë shekujve, dhe pushteti yt brez pas brezi.

Zoti është i besueshëm në gjithë fjalët e tij dhe i drejtë në tërë veprat e tij.

Zoti përkrah gjithë ata që pengohen dhe ngre gjithë ata që bien.

Sytë e të gjithëve te Ty e kanë shpresën dhe Ti u jep ushqimin në kohën e duhur.

Ti hap dorën tënde dhe çdo gjë të gjallë e mbush me mirësi.

I drejtë është Zoti në tërë rrugët e tij dhe i shenjtë në të gjitha veprat e tij.

Zoti është afër atyre që i luten, atyre që i luten me të vërtetë.

Do t'ua plotësojë dëshirën atyre që ia kanë frikën dhe lutjen e tyre do ta dëgjojë dhe do t'i shpëtojë.

Zoti ruan gjithë ata që e duan; po gjithë mëkatarët do t'i shuajë.

Nga goja ime do të dalin lavdërime për Zotin, dhe çdo trup le ta lavdërojë emrin e tij të shenjtë në jetë, e në jetë të jetës.

*Në kohën që anagnosti lexon psalmet, prifti ndan naforën duke i thenë secilit:*

**Prifti:** Bekimi dhe mëshira e Zotit ardhte mbi ju.

*Dhe si mbaron së ndari naforën, shton:*

**Prifti:** Me hirin e Tij hyjnor dhe njeridashjen, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Pasi anagnosti mbaron psalmi 33 dhe 144, prifti thotë me zë të lartë:*

**Prifti:** Me urarat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Iisu Krisht Perëndi, mëshirona edhe shpëtona.

**Psaltët:** Amin.

*Pastaj prifti shkon në proskomidhi (në qoftë se nuk ka dhiak), dhe pi tepricën e kungatës që është në potir, pastaj si shplan potirin më parë me verë dhe pastaj me ujë, e fshin dhe i mbulon me mbulesat dhe thotë falenderimin e kungatës. Pastaj prifti dhe dhiaku lajnë duart, zhveshin rrobat e meshës dhe thonë troparin e Shën Simeonit:*

**Prifti:** Tani përlëshoje shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, me paqe, se sytë e mi panë shpëtimin tënd, të cilin ti

e përgatite faqe gjithë popujve, drite për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (*tri herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e tërëshenjtë mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia e Atit, e Birit, edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (*12 herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Më të nderuarën se keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen; ty të madhërojmë.

*Dhe bën përlëshimin e vogël në këtë mënyrë:*

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

Krishti Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e nënës së tij të pacenuar dhe krejt të papërlyer dhe të shenjtë, të etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës; të hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joaqim dhe Ana dhe të gjithë shenjtorëve të tij, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

*Mbarim i Meshës së Dhuratave të parashenjtëruara*